

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, dhe propozohet në kuadër të paketës fiskale 2019.

Ky projektligj synon:

- nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në fushën e digjitalizimit të mediave audiovizive;
- nxitjen dhe zhvillimin e “transportit publik të gjelbër”, duke zëvendësuar autobusët e transportit publik me naftë me autobus elektrikë;
- mbështetjen e sektorit bujqësor, duke lehtësuar kostot e investimit;
- adresimin e kërkesës së industrisë fasone për përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar;
- zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, duke lehtësuar koston e lëndëve të para për prodhimin e tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

1. Dispozita e nenit 49, të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon që përveç shkallës standarde (20 për qind) të mund të aplikohen edhe shkallë të reduktuara të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH). Aktualisht, aplikohet një shkallë e reduktuar, sikurse është ajo prej 6 për qind, kryesisht për furnizimin e shërbimit të akomodimit në sektorin e hoteleri-turizmit.

- Furnizimi (shitja) i shërbimit të reklamave nga media elektronike është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, sipas shkronjës “j”, të nenit 53, të ligjit “Për TVSH-në”, dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji, këto subjekte nuk mund të zbresin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, të kryera në funksion të furnizimeve të përjashtuara, ndryshe nga subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme dhe zbresin TVSH-në e paguar në blerje. TVSH-ja e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, në këtë rast, është kosto për mediat.

Me qëllim nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në kuadër të digjitalizimit të mediave audiovizive (televizionet), propozohet që shkalla e reduktuar 6 për qind të aplikohet edhe për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive (televizionet).

- Transporti rrugor është një kontribues mjaft i madh i ndotjes së ajrit dhe mjedisit. Pikërisht kjo ndotje e madhe çon në kërkimin e të ashtuquajturit “Transport të gjelbër”, që do të thotë çdo lloj praktike e transportit apo automjet, që është eko-miqësore dhe që nuk ka ndikim negativ në mjedis. Një nga mënyrat e transportit të gjelbër është e lidhur pikërisht me transportin publik me autobus, nëpërmjet zëvendësimit të autobusëve me naftë me autobusë elektrikë. Me qëllim futjen dhe nxitjen e përdorimit të autobusëve elektrikë në ofrimin e shërbimit të transportit publik të udhëtarëve me autobus, propozohet që furnizimi i tyre të mos trajtohet me shkallën standarde të TVSH-së 20 për qind por të aplikohet një shkallë e reduktuar prej 10 për qind.

2. Në zbatim të pikës 41, të nenit 56, të ligjit “Për TVSH-në”, aktualisht është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja importimi i makinave bujqësore, sipas listës, procedurës dhe kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr.953/2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Me qëllim lehtësimin e kostove të investimit dhe vijimin e mbështetjes së sektorit bujqësor, propozohet që furnizimi i makinave bujqësore të jetë furnizim i përjashtuar jo vetëm në import por edhe brenda vendit, sipas po së njëjtës listë makinash bujqësore, të miratuar me vendimin e sipërpërmendur të Këshillit të Ministrave.

Duke qenë se tashmë furnizimi i makinave bujqësore do të jetë i përjashtuar si në import ashtu dhe kur shitet brenda vendit, për të gjithë personat, propozohet që ky furnizim të përfshihet në listën e furnizimeve të përjashtuara brenda vendit (neni 53 i ligjit për TVSH-në) dhe si i tillë në zbatim të pikës 1, të nenit 56, të ligjit, është furnizim i përjashtuar dhe në import. Për rrjedhojë, hiqet parashikimi sipas pikës 41, të nenit 56, që përcakton përjashtimin e makinave bujqësore vetëm në import.

3. Aktualisht furnizimi i shërbimit të përpunimit të mallrave joshqiptare të

destinuara për t'u rieksporuar, të kryera nga nënkontraktorët për llogari të shoqërisë së përpunimit aktiv që e ka kontraktuar, është furnizim i tatueshëm me shkallën standarde 20 për qind, ndërkohë që më herët ky furnizim ka qenë i përjashtuar nga TVSH-ja. Me qëllim adresimin e kërkesës së industrisë fasone e cila ka kërkuar që përsëri ky furnizim të trajtohet si furnizim i përjashtuar, propozohet përfshirja e këtij furnizimi në listën e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja. Gjithashtu, parashikohet që ministri përgjegjës për financat të përcaktojë me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e përjashtimit.

4. Furnizimi i barnave është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, si brenda vendit dhe në import, në përputhje me nenin 51, të ligjit "Për TVSH-në" dhe si i tillë, për këto furnizime, subjektit që i kryen ato, nuk i lind e drejta e zbritjes së TVSH-së. TVSH-ja e paguar në këtë rast është kosto. Me qëllim zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, duke lehtësuar koston e lëndëve të para për prodhimin e tyre, propozohet që importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat, të jetë furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Ndërkohë që, nuk e përfitojnë përjashtimin nga TVSH-ja lëndët e para që janë me përdorim të dyfishtë. Gjithashtu, parashikohet që lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave, të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk përafron me direktivën e BE-së nr.2006/112/EC, "Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 5 nene:

Neni 1 parashikon trajtimin me shkallë të reduktuar 6 për qind për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive. Gjithashtu, po në këtë nen propozohet edhe aplikimi i një shkalle tjetër të reduktuar 10 për qind për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me dhjetë vënde ose më shumë, vetëm me motor elektrik.

Neni 2 parashikon trajtimin e furnizimit të makinave bujqësore si furnizim të

përfshirë nga TVSH-ja. Lista e makinave bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3 parashikon heqjen nga lista e furnizimeve të përfshiuara nga TVSH-ja të furnizimit të shërbimit të reklamave nga media elektronike.

Gjithashtu, po në këtë nen parashikohet që kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuar për t'u riekportuar, për personat e tatueshëm të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv, të jetë furnizim i përfshirë nga TVSH-ja.

Neni 4 parashikon që të hiqet pika 41, e nenit 56, të ligjit "Për TVSH-në". Gjithashtu, parashikohet që po në dispozitën e nenit 56, të ligjit "Për TVSH-në" të shtohet parashikimi për trajtimin si furnizim i përfshirë në import i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, me përfshirje të lëndëve me përdorim të dyfishtë, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat. Lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5 parashikon botimin në "Fletoren zyrtare" dhe hyrjen në fuqi të ligjit në datën 1 janar 2019.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, administrata tatimore dhe administrata doganore për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji paraqet efekte buxhetore, të cilat përafërsisht vlerësohen në masën minus 300 000 000 (treqind milionë) lekë, por që parashikohet të sjellë efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve që preken nga parashikimet e tij.

KËSHILLI I MINISTRAVE